Република Северна Македонија
Republika e Maqedonisë së Veriut
Republic of North Macedonia

Ревизорско тело за ревизија на ИПА
Trupi i Revizionit për revizion të IPA-s
Audit Authority for audit of IPA

Бр./Nr ._____
Скопје/Shkup,_____20_____

PLANI STRATEGJIK I TRUPIT TË REVIZIONIT PËR REVIZION TË INSTRUMENTIT TË NDIHMËS SË PARAANËTARËSIMIT

2025 – 2029

Shkup, dhjetor 2024

Republika e Maqedonisë së Veriut

TRUPI I REVIZIONIT
PËR REVIZION TË INSTRUMENTIT TË NDIHMËS SË PARANËTARËSIMIT

rr. 11 Tetori, numër 36,
1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut
Telefon: ++389 (02) 3215-621;
Tel./ faksi: ++389 (02) 3222-304
E-mail: ipa_aa@aaipa.gov.mk
Ueb: http://www.aaipa.gov.mk

Plani strategjik i Trupit të Revizionit për vitet 2025-2029 u miratua nga u.d. Revizori kryesor i IPA-s në muajin dhjetor, 2024.

Trupi i Revizionit e publikon këtë plan strategjik, si një udhëzues për punën për periudhën e përcaktuar.

Plani strategjik përmban pesë objektiva strategjike të lidhura ngushtë me misionin e Trupit të Revizionit.

Gjatë realizimit të këtij plani strategjik, nëse paraqitet nevoja e revizionit të qëllimeve strategjike, ai do të përditësohet në pjesën e aktiviteteve, rezultatet e pritshme dhe afatet e zbatimit, në nivel vjetor.

PËRMBAJTJA **faqe**

HYRJE *3*
PARIMET THEMELORE NË FUNKSIONIMIN E TRUPIT TË REVIZIONIT *12*
MISIONI *11*
VIZIONI *11*
QËLLIMET DHE PRIORITETET STRATEGJIKE *11*
QËLLIMI STRATEGJIK 1 *12*
QËLLIMI STRATEGJIK 2 *12*
QËLLIMI STRATEGJIK 3 *13*
QËLLIMI STRATEGJIK 4 *15*
QËLLIMI STRATEGJIK 5 *16*
ZBATIMI I QËLLIMIT STRATEGJIK 18
NDJEKJA E ZBATIMIT TË QËLLIMEVE STRATEGJIKE 18
FAKTORËT E RREZIKUT PËR ZBATIM TË SUKSESSHËM TË QËLLIMEVE STRATEGJIKE 18
SIGURIMI I MJETEVE FINANCIARE PËR ZBATIMIN E QËLLIMIT STRATEGJIK 19

Shtojcë

PLANI I VEPRIMIT I TRUPIT TË REVIZIONIT PËR ARRITJEN E QËLLIMEVE STRATEGJIKE 2025-2029..... 1-8

Shkurtesat e përdorura:

- **KE -** Komisioni Evropian
- **BE**- Bashkimi Evropian
- **IPA -** Instrumenti për Ndihmën e Paraanëtarësimit
- **IPA Rregullore** - Rregullore për zbatimin e IPA-s
- **NAO** - Koordinatori Nacional i Autorizimit
- **Trupi i Revizionit** - Trupi i Revizionit për revizionin e Instrumentit të Ndihmës së Paranëtarësimit (IPA)
- **RMV**- Republika e Maqedonisë së Veriut

HYRJE

Përcaktimi strategjik i Republikës së Maqedonisë së Veriut është anëtarësimi në bashkësinë e shteteve të Bashkimit Evropian, që në vetvete nënkupton se Trupi i revizionit për revizionin e Instrumentit të Ndihmës së Paranëtarësimit (IPA) (këtu e tutje referuar si Trupi i Revizionit) duhet të harmonizohet plotësisht me mënyrën dhe rregullat e funksionimit dhe zbatimit të Standardeve dhe Praktikës më të mirë të Bashkimit Evropian.

Me Vendim të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, në korrik të vitit 2007, Trupi i Revizionit është themeluar në kuadër të Entit Shtetëror të Revizionit, dhe që nga qershori i vitit 2011 ka ushtruar kompetencat e veta si subjekt juridik i pavarur në pajtim me Ligjin për revizionin e Instrumentit të Ndihmës së Paranëtarësimit (IPA).

Instrumenti i Ndihmës së Paranëtarësimit është krijuar për herë të parë me miratimin e Rregullores së Këshillit (KE) nr. 1085/2006 të 17 korrikut 2006, dhe kishte të bënte me periudhën programore 2007-2013 (këtu e tutje referuar si IPA I). Qëllimi i kësaj rregullore ishte ofrimi i ndihmës së paranëtarësimit, për vendet përdoruese si mbështetje për zbatimin e reformave të nevojshme për plotësimin e kërkesave të Komunitetit, deri në anëtarësimin e tyre në Bashkimin Evropian.

Ndihma IPA I u zbatua nëpërmjet komponentëve të mëposhtëm:

Ndihma për tranzicionin dhe përmirësimin institucional;
II Bashkëpunimi ndërkufitar;
III Zhvillimi rajonal;
IV Zhvillimi i burimeve njerëzore dhe
V Zhvillimi rural.

Për të zbatuar rregulloren e përmendur më sipër, Komisioni i Komuniteteve Evropiane miratoi rregulloren nr. 718/2007[1]më 12 qershor 2007. Kjo rregullore futi rregulla të përbashkëta për zbatimin e ndihmës për të pesë komponentët e IPA I.

Kjo u pasua nga miratimi i një kornize ligjore, që i përket periudhës së dytë programore IPA 2014-2020. Në gjysmën e parë të vitit 2014, u miratuan Rregullorja (BE) Nr.231/2014 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 11 marsit 2014, për krijimin e Instrumentit për Ndihmën e Paranëtarësimit (IPA II), Rregullorja (BE) Nr. 236/2014 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 11 marsit 2014, për përcaktimin e rregullave dhe procedurave të përbashkëta për zbatimin e instrumenteve të Unionit për financimin e veprimeve të jashtme (Rregullorja e Përbashkët Zbatuese) dhe Rregullorja (BE) Nr. 447/2014 e 2 majit 2014, për rregullat specifike për zbatimin e Rregullores (BE) Nr. 231/2014 të Parlamentit

Rregullore (KE) Nr. 718/2007 datë 12 korrik 2007 "Për zbatimin e Rregullores së Këshillit (KE) Nr. 1085/2006, që përcakton instrumentin për ndihmën paranëtarësimit[1]

Evropian dhe të Këshillit, për krijimin e një Instrumenti të Ndihmës së Paranëtarësimit (IPA II) (IPA II Rregullorja Zbatuese) me të cilën janë vendosur rregullat e përdorimir të mjeteve të IPA II në periduhën e programimit 2014-2020 (në tekstin e mëtejmë IPA II) Struktura administrative në Republikën e Maqedonisë së Veriut e akredituar për menaxhim të decentralizuar të fondeve IPA I, vazhdoi të kryejë funksionet dhe kompetencat e saj në menaxhimin e fondeve IPA II, në periudhën programore 2014-2020.

Ndihma nga IPA II, është programuar dhe zbatuar për zhvillimin e 8 sektorëve nëpërmjet pesë fushave të mëposhtme (fusha e politikave 1-5):

1. Reformat në përgatitje për anëtarësimin në Bashkimin Evropian, dhe me to lidhshmëria e përmirësimit të institucioneve dhe kapaciteteve
   - Sektori Demokracia dhe menaxhimi dhe
   - Sundimi i ligjit dhe të drejtat themelore;
2. Zhvillimi socio-ekonomik dhe rajonal;
   -Mjedisi jetësor dhe aktivitetet klimatike
   -Transporti
3. Punësimi, politika sociale, arsimi, promovimi i barazisë gjinore dhe zhvillimi i burimeve njerëzore;
   - Arsimi, punësimi dhe politikat sociale
4. Bujqësia dhe zhvillimi rural dhe
   - Bujqësia dhe zhvillimi rural.
5. Bashkëpunimi rajonal dhe territorial.
   - Bashkëpunimi rajonal dhe territorial

Në pajtim me Rregulloren për IPA II të qershorit 2015, Marrëveshja Kornizë ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Komisionit Evropian, me të cilën rregullohen procedurat e zbatimit të ndihmës financiare nga Unioni për Republikën e Maqedonisë, në kuadër të zbatimit të ndihmës sipas IPA II, si dhe Marrëveshja sektoriale e zbatimit të ndihmës sipas IPARD II, Trupi i Revizionit kryen aktivitetet e mëposhtme:

a) revizion për të verifikuar plotësinë, saktësinë dhe vërtetësinë e raporteve financiare vjetore, ose ekstrakteve dhe llogarive vjetore adekuate;

b) revizion për të verifikuar funksionimin efikas dhe efektiv të sistemeve të menaxhimit, kontrollit dhe mbikëqyrjes;

c) revizion për të verifikuar ligjshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve të bëra;

ç) Kjo u pasua nga miratimi i një kornize ligjore, që i përket periudhës së dytë programore IPA 2014-2020.

e) përgatit mendimet vjetore të revizionit për raportet financiare vjetore ose ekstraktet dhe llogaritë adekuate vjetore, për vitin financiar paraardhës, duke kontrolluar plotësinë, saktësinë dhe besueshmërinë e tyre, për funksionimin e sistemeve të menaxhimit, kontrollit dhe mbikëqyrjes, dhe ligjshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve, të mbështetura nga raportet vjetore të aktiviteteve të revizionit, që

tregojnë çdo mangësi të hasur në sistemet e menaxhimit, kontrollit dhe mbikëqyrjes dhe çdo masë korrigjuese të marrë ose të planifikuar nga NAO, NF dhe/ose strukturat operative në fjalë; dhe

f) përgatit Mendim për çdo deklaratë financiare përfundimtare të shpenzimeve, që NAO i ka dorëzuar Komisionit, për mbylljen e cilitdo program, ose pjesë të së njëjtës. Ku është e përshtatshme, lëshon Raport Përfundimtar të Aktivitetit të Revizionit që mbështet mendimin.

Zbatimi i IPA II është në rrjedhë, dhe për të ruajtur vazhdimësinë në zbatim, Rregullorja (BE) 2021/947 e Parlamentit Evropian, dhe e Këshillit e 9 qershorit 2021, për krijimin e një Instrumenti për Fqinjësinë, Zhvillimin dhe Bashkëpunimin Ndërkombëtar - Evropa Globale, Rregullorja për krijimin e një Instrumenti për Ndihmën e Paranëtarësimit (IPA III) të Parlamentit Evropian, dhe të Këshillit për periudhën 2021-2027, numri 1529/2021 i 15 shtatorit 2021, Rregullorja e Komisionit (BE) Nr. 2021/2236 e 15 dhjetorit 2021, për zbatimin e rregullave specifike për zbatimin e Rregullores (BE) 1529/2021 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, për krijimin e një Instrumenti për Ndihmën e Paranëtarësimit (IPA III), me të cilin përcaktohen rregullat e përdorimit të mjeteve IPA III, në periudhën e programimit 2021-2027. Njëkohësisht, Marrëveshja Kornizë për Partneritet Financiar ndërmjet Komisionit Evropian dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut, e përfaqësuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, mbi procedurat e veçanta të zbatimit të ndihmës financiare të Unionit për Republikën e Maqedonisë së Veriut, në kuadër të Instrumentit të Ndihmës së Paranëtarësimit (IPA III), është ratifikuar dhe botuar në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" Nr. 235/2022.

Sipas rregulloreve të përmendura, ndihma nga IPA III, do të zbatohet nëpërmjet pesë dritareve që mbulojnë programet operative përkatëse:

- Dritarja 1: Sundimi i ligjit, të drejtat themelore dhe demokracia;
- Dritarja 2: Qeverisja e mirë, harmonizimi i legjislacionit, marrëdhëniet e mira fqinjësore dhe komunikimi strategjik;
- Dritarja 3: Agjenda e gjelbër dhe lidhshmëria e qëndrueshme;
- Dritarja 4: Konkurrueshmëria dhe rritja gjithëpërfshirëse;
- Dritarja 5: Bashkëpunimi territorial dhe ndërkufitar

Në pajtim me Rregulloren IPA 2021/1529 për themelimin e Instrumentit për Ndihmë Paranëtarësimit (IPA III), dhe Marrëveshja kornizë për partneritet financiar ndërmjet Komisionit Evropian dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut të përfaqësuar nga Qeveria Republika e Maqedonisë së Veriut, për procedurat e veçanta për zbatimin e ndihmës financiare nga Unioni, për Republikën e Maqedonisë së Veriut, sipas Instrumentit të Ndihmës së Paranëtarësimit (IPA III), si dhe Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Komisionit Evropian, për themelimin e dispozitave për menaxhimin dhe zbatimin e ndihmës financiare të Unionit

për Republikën e Maqedonisë së Veriut, sipas Programit për zhvillim rural të Instrumentit të Ndihmës së Paranëtarësimit (IPARD III), Trupi i Revizionit do të kryejë aktivitetet e mëposhtme:

a) revizion për të verifikuar plotësinë, saktësinë dhe vërtetësinë e raporteve financiare vjetore, ose ekstrakteve dhe llogarive vjetore adekuate;

b) revizion për të verifikuar funksionimin efikas dhe efektiv të sistemeve të menaxhimit, kontrollit dhe mbikëqyrjes;

c) revizion për të verifikuar ligjshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve;

d) përgatit një Strategji Revizioni trevjeçare;

e) përgatit një Mendim Vjetor të Revizionit për vitin financiar paraardhës së bashku me Raportin Vjetor të aktiviteteve të Revizionit dhe

f) përgatit Mendim për çdo deklaratë financiare përfundimtare të shpenzimeve, që NAO i ka dorëzuar Komisionit, për mbylljen e cilit do program, ose pjesë të së njëjtës. Ku është e përshtatshme, lëshon Raport Përfundimtar të Aktivitetit të Revizionit që mbështet mendimin.

f) përgatit raportet përfundimtare të revizionit, nga revizionet sistemike të kryera dhe t'i dorëzojë ato në Komision.

Gjatë zbatimit të IPA II/IPAIII, strategjitë trevjeçare të revizionit i dorëzohen Drejtorisë së Përgjithshme për fqinjësi dhe negociata të zgjerimit, Drejtorisë së Përgjithshme për bujqësi dhe zhvillim rural dhe në NAO, ndërsa raportet dhe mendimet vjetore i dorëzohen Drejtorive të Përgjithshme përkatëse në Komisionin Evropian dhe Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me një kopje në NIPAK dhe NAO.

Korniza ligjore për revizionin e IPA-s dhe funksionimin e Trupit të Revizionit përcaktohen në Marrëveshjen kornizë ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Komisionit Evropian që rregullon procedurat për zbatimin e ndihmës financiare nga Unioni për Republikën e Maqedonisë në kuadër të zbatimit të ndihmës në kuadër të IPA II, Marrëveshjes Kornizë për partneritet financiar ndërmjet Komisionit Evropian dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut të përfaqësuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut për procedurat e veçanta për zbatimin e ndihmës financiare nga Unioni për Republikën e Maqedonisë së Veriut nën Instrumentin e Ndihmës së Para-Anëtarësimit (IPA III), Ligji për revizionin e IPA (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 66/10, 43/14, 154/15, 27/16, 190/16, 83/18 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 251/22 dhe 262/23).

Trupi i Revizionit në pajtim me rregulloren e mësipërme funksionon si një person juridik i pavarur dhe i mëvetësuar, që është funksionalisht i pavarur nga të gjithë pjesëmarrësit në sistemet e menaxhimit, kontrollit dhe mbikëqyrjes së mjeteve nga Instrumenti i Ndihmës së Paraanëtarësimit.

Ligji për Revizion të IPA-s, rregullon lëndën e revizionit, organizimin dhe kompetencat e Trupit të Revizionit për revizion të Instrumentit të Ndihmës Paranëtarësimit në

Republikën e Maqedonisë së Veriut. Njëkohësisht me marrëveshjet kornizë[2] dhe marrëveshjet sektoriale për IPARD[3] të lidhura ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Bashkimit Evropian, përcaktohet funksioni, kompetencat dhe përgjegjësitë e Trupit të Revizionit në një sistem të decentralizuar/indirekt për menaxhim, kontroll dhe mbikëqyrje të ndihmës së paranëtarësimit të Bashkimit Evropian në Republikën e Maqedonisë.

Zhvillimi i mëtejshëm i Trupit të Revizionit do të realizohet në kushtet e:

- procesit intensiv të afrimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut me Bashkimin Evropian, nëpërmejt fillimit të negociatave për anëtarësim në Union;
- proceset intensive të reformave në të gjitha fushat e jetës ekonomike dhe politike; proceset reformuese në administratën publike, veçanërisht në sistemin e kontrollit financiar dhe luftës kundër korrupsionit në vend;
- aktivitete dhe procese intensive për bashkëpunim me institucionet financiare dhe politike ndërkombëtare.

Me anëtarësimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në NATO, është zbatuar një prioritet i rëndësishëm strategjik, i cili është një parakusht i sigurt për zbatimin e strategjive afatgjata, për zhvillimin e mëtejshëm në të gjitha fushat e shoqërisë.

Trupi i Revizionit drejtohet nga Revizori kryesor i IPA-s (RKIPA), të cilin e emëron Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut për një mandat 9-vjeçar. Revizori kryesor i IPA-s, ka një zëvendës (ZRKIPA) me mandat 9-vjeçar. Trupi i Revizionit organizohet nga tre këshilltarë të RKIPA-s, dhe shtatë njësi kryesore organizative – sektorë nëpërmjet të cilëve ushtron kompetencat e tij, duke përfshirë pesë Sektorë të revizionit, Sektorin e avancimit të revizionit, dhe Sektorin e Punëve Financiare dhe Juridike Administrative. Aktualisht, në Trupin e Revizionit janë të punësuar 30 persona dhe dy funksionarë (të gjithë me arsim të lartë), 16 prej të cilëve (me RKIPA dhe ZRKIPA) posedojnë certifikatë të revizorët shtetëror, 2 janë doktor të shkencave ekonomike, 11 janë magjistra në fushën përkatëse, 1 është revizor i brendshëm i autorizuar në sektorin publik, 1 Inxhinier i diplomuar ndërtimtarie, 1 hetues i certifikuar për mashtrime dhe 11 kontabilistë të autorizuar, 1 menaxher i certifikuar për menaxhim me rreziqe nga korrupsioni, që është një bazë solide për kryerjen kompetente të aktiviteteve të punës.

[2] Marrëveshje kornizë e lidhur ndërmjet Komisionit të Komuniteteve Evropiane dhe Republikës së Maqedonisë, për rregullat e bashkëpunimit në lidhje me ndihmën financiare të BE-së për RM-në, në kuadër të zbatimit të ndihmës sipas Instrumentit për Ndihmë Paranëtarësimit (IPA) (Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 18/08) dhe
Marrëveshja kornizë ndërmjet Republikës së Maqedonisë, e përfaqësuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë dhe Komisioni Evropian, për procedurat e zbatimit të ndihmës financiare nga Unioni për RM-në, në kuadër të zbatimit të ndihmës sipas IPA II (Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 99/15)

[3] Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Komisionit të Komuniteteve Evropiane, për Rregullat e Bashkëpunimit në lidhje me ndihmën financiare të KE-së të RM-së, dhe zbatimin e ndihmës sipas komponentit V (IPARD) të IPA (Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 165/08) dhe
Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Komisionit Evropian, për vendosjen e dispozitave për menaxhimin dhe zbatimin e ndihmës financiare të Unionit për Republikën e Maqedonisë sipas IPA-s, në fushën e politikave të "Bujqësisë dhe zhvillimit rural" (IPARD) (Gazeta zyrtare e RM-së nr. 38/16)

Trupi i Revizionit, Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, i dorëzon çdo vit për shqyrtim dhe informim një raport vjetor nga revizioni i raporteve financiare të shoqërisë për revizion.

Punonjësit e Trupit të Revizionit janë të përfshirë në procesin e formimit dhe fuqizimit të vazhdueshëm profesional dhe arritjes së përvojës, në zbatimin e standardeve të pranuara ndërkombëtarisht për revizion, standarde dhe rregullore të tjera, si dhe arritjet më të fundit në praktikën e revizionit, në pajtim me standardet dhe kriteret e vendosura të Bashkimit Evropian. Në punën e tij, Trupi i Revizionit përdor përvojën, shkathtësitë dhe njohuritë e fituara nga puna deri më tani, duke i përmirësuar dhe përshtatur ato me kërkesat specifike të Komisionit Evropian, për revizionin e fondeve të përdorura nga IPA.

Për kryerjen e aktiviteteve të revizionit në Trupin e Revizionit, mjetet bazë të përdorura janë:

- IPA Manuali i revizionit, versioni 3, dhjetor 2018 i përbërë nga Pjesa e Përgjithshme, Pjesa e Posaçme e revizionit të IPA II përfushën e politikës 1,2 dhe 3 dhe Pjesa e Posaçme e revizionit të IPARD II të fushës së politikës 4, si ndihmë profesionale në praktikën e revizionit;
- Manualet e revizionit IPA III, versioni 1, mars 2023 i përbërë nga Pjesa e Posaçme I, Pjesa e Veçantë II për revizionin e Programeve IPA III dhe Pjesa e Posaçme III për revizionin e Programeve IPARD III) të cilat janë kyçe për përgatitjen e revizorëve për periudhën e ardhshme programore IPA III, 2021-2027

Për të përmirësuar punën dhe për të avancuar bashkëpunimin në ushtrimin e kompetencave të Trupit të Revizionit, si dhe shkëmbimin e përvojave, janë lidhur memorandume bashkëpunimi me institucione të ndryshme nga vendi dhe rajoni.

- Memorandum bashkëpunimi me Universitetin FON, Shkup në vitin 2019,
- Memorandum bashkëpunimi me Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit në shkurt 2021,
- Memorandum Bashkëpunimi me Trupin e Revizionit të Republikës së Malit të Zi në korrik 2021,
- Memorandum bashkëpunimi me Zyrën Nacionale të Revizionit të Republikës së Kosovës në gusht 2021,
- Memorandum Bashkëpunimi me Trupin e Revizionit të Republikës së Shqipërisë në nëntor 2021,
- Memorandum Bashkëpunimi me Ministrinë e Financave, në qershor 2023,
- Në dhjetor 2021, Revizori kryesor për IPA, i Trupit të Revizionit për revizionin e IPA-s, shkëmbeu letra bashkëpunimi me Drejtorin e Përgjithshëm të Zyrës Evropiane kundër Mashtrimit OLAF, duke konfirmuar gatishmërinë për të përmirësuar më tej bashkëpunimin brenda mandateve përkatëse, për të mbrojtur interesat financiare të BE-së,

PARIMET THEMELORE NË PUNËN E TRUPIT TË REVIZIONIT

Pavarësia
Funksionalisht dhe operacionalisht i pavarur nga të gjithë pjesëmarrësit në sistemet e menaxhimit, kontrollit dhe mbikëqyrjes me IPA, dhe përputhet me standardet e revizionit të pranuara ndërkombëtarisht, si kusht për ushtrimin efektiv të kompetencave të Trupit të Revizionit;

Kompetenca
Zotërimi i njohurive, përvojës, objektivitetit, integritetit dhe autoritetit në shprehjen e mendimit të revizionit, konkluzioneve dhe rekomandimeve nga revizorët duke i kushtuar vëmendjen dhe kujdesin e duhur në zbatimin e standardeve të revizionit të pranuara ndërkombëtarisht;

Objektiviteti
Objektiviteti në kryerjen e revizioneve, ndershmëria dhe pa konflikt interesi, dhe dhënia e mendimeve bazuar vetëm në provat e siguruara dhe të formuara në pajtim me standardet e pranuara ndërkombëtare të revizionit;

Neutraliteti
Mirëmbajtja e vazhdueshme e pavarësisë së revizorëve nga ndikimet politike, duke kryer detyrat e revizionit në mënyrë të paanshme;

Racionaliteti
Kryerja e punëve të revizionit duke shpenzuar burimet minimale financiare, që nënkupton shfrytëzimin ekonomik, efikas dhe efektiv të fondit të revizionit në orë;

Konfidencialiteti
Të dhënat dhe njohuritë e fituara gjatë revizionit mbahen nga revizorët si sekret biznesi, dhe parandalojnë paraqitjen e tyre të paautorizuar tek të tjerët;

Profesionalizmi
Ndjekje e vazhdueshëm e risive në fushën e revizionit, zbatimi i teknikave dhe ndihmave më të fundit të revizionit, dhe përmirësimin e vazhdueshëm të aftësive dhe shkathtësive të revizorëve;

Puna ekipore
Praktika e vazhdueshme e bashkëpunimit kolegjial, gjithëpërfshirëse, konstruktive dhe krijuese e revizorëve me respekt të vazhdueshëm për individin, duke forcuar ndjenjën e përgjegjësisë, ndërgjegjes dhe profesionalizmit, si kusht për arritjen e vizionit, misionit dhe qëllimeve strategjike të Trupit të Revizionit.

MISIONI

Trupi i Revizionit, është një revizor i jashtëm i pavarur, përgjegjës për revizionin dhe dhënien e mendimit për funksionimin e duhur të sistemeve të menaxhimit, kontrollit dhe mbikëqyrjes së ndihmës së paraanëtarësimit të BE-së, në Republikën e Maqedonisë së Veriut, për plotësinë, saktësinë dhe besueshmërinë e raporteve financiare vjetore ose ekstrakteve, për ligjshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve, që rezultojnë në mënyrë që të mbrohen interesat financiare të komunitetit dhe interesat nacionale.

VIZIONI

Përmirësimi i procesit të menaxhimit efikas dhe efektiv të fondeve IPA, llogaridhënies dhe transparencës në përdorimin e tyre, duke siguruar vazhdimisht integritetin dhe cilësinë në revizione me qëllim të ofrimit të mendimeve dhe rekomandimeve të duhura të revizionit, për funksionim më efektiv dhe të qëndrueshëm të sistemeve kompetente për menaxhimin, kontrollin dhe mbikëqyrjen e ndihmës së paranëtarësimit të BE-së në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

QËLLIMET STRATEGJIKE DHE PRIORITETET

- ***Qëllimi 1: Mirëmbajtja e pavarësisë funksionale***

Mirëmbajtja e vazhdueshme e pavarësisë funksionale dhe operative e Trupit të Revizionit, në revizionin e sistemeve të menaxhimit, kontrollit dhe mbikëqyrjes, si dhe të aktiviteteve, transaksioneve dhe llogarive vjetore, në pajtim me standardet e revizionit të pranuara ndërkombëtarisht;

- Qëllimi 2: ***Forcimi i kapaciteteve institucionale***

Sigurimi i burimeve të përshtatshme financiare, hapësinore, teknike dhe njerëzore si parakusht për ushtrimin e kompetencave të Trupit të Revizionit;

- Qëllimi 3: ***Sigurimi i cilësisë së revizioneve të kryera***

Zhvillimi dhe përmirësimi i procedurave për kryerjen e revizioneve, në pajtim me rregulloret IPA dhe miratimi i standardeve të pranuara ndërkombëtarisht, për revizionin dhe ndjekjen e efekteve të revizioneve;

- Qëllimi 4: ***Zhvillimi i sistemit të informacionit dhe teknologjisë informatike***

Zhvillimi dhe mirëmbajtja e mëtejshme e sistemit të informacionit të Trupit të Revizionit, zbatimi i teknologjisë informatike dhe përdorimi racional dhe efikas i tij në revizion;

- ***Qëllimi 5: Zhvillimi i sistemit të komunikimit***

Zhvillimi i mëtejshëm i sistemit të komunikimit dhe shkëmbimit të informacionit me strukturën administrative për IPA-n, me subjekte juridike vendase dhe ndërkombëtare, dhe informimi i publikut për punën e Trupit të Revizionit.

QËLLIMI STRATEGJIK 1

Mirëmbajtja e pavarësisë funksionale

Mirëmbajtja e vazhdueshme e pavarësisë funksionale dhe operative të Trupit të Revizionit, në revizionin e sistemeve të menaxhimit, kontrollit dhe mbikëqyrjes, si dhe të aktiviteteve, transaksioneve dhe llogarive vjetore, në pajtim me standardet e revizionit të pranuara ndërkombëtarisht;

Qëllimi direkt 1.1.

Mirëmbajtja e vazhdueshme e pavarësisë funksionale dhe operative e Trupit të Revizionit nga sistemet e menaxhimit, kontrollit dhe mbikëqyrjes së fondeve IPA.

Aktivitete

Miratimi i një Ligji të ri për revizionin e programeve të financuara nga BE-ja

Qëllimi direkt 1.2.

Zhvillimi i mëtejshëm i pavarësisë funksionale dhe organizative të Trupit të Revizionit.

Aktivitete

- Ndryshimet dhe plotësimet/miratimi i akteve të reja të brendshme për organizimin e brendshëm dhe punën, dhe sistematizimin e punëve të Trupit të Revizionit;
- Përditësimi i Analizës së ngarkesës në vendet e punës (WLA);
- Përditësim i Strategjisë së menaxhimit të burimeve njerëzore;
- Ndarja e duhur e burimeve njerëzore brenda sektorëve dhe ekipeve të revizionit, si dhe përcaktimi i personave përgjegjës/udhëheqësve të ekipit të revizionit, sipas nevojave të revizionit dhe strategjive të revizionit.

QËLLIMI STRATEGJIK 2

Forcimi i kapaciteteve institucionale

Sigurimi i burimeve të përshtatshme financiare, hapësinore, teknike dhe njerëzore si parakusht për ushtrimin e kompetencave të Trupit të Revizionit;

Qëllimi direkt 2.1.

Sigurimi i burimeve të nevojshme financiare, për ushtrimin e kompetencave të Trupit të Revizionit dhe forcimin e burimeve njerëzore.

Aktivitete

- Sigurimi i burimeve të nevojshme financiare për kushtet hapësinore, materiale dhe teknike për punën me buxhetet vjetore të Trupit të Revizionit;
- Sigurimi i ambienteve të veta afariste;
- Sigurimi i burimeve të nevojshme financiare me Buxhetin e Trupit të Revizionit për punonjësit ekzistues, për avancim dhe punësimin e stafit të ri të nevojshëm;
- Sigurimi i burimeve të nevojshme financiare me Buxhetin e Trupit të Revizionit, për ndjekjen e takimeve teknike dhe dypalëshe me Drejtoritë e Përgjithshme kompetente;
- Sigurimi i burimeve të nevojshme financiare për trajnimin e punonjësve në Trupin e Revizionit, me qëllim forcimin e kapaciteteve në drejtim të rritjes së shkallës së kualifikimit duke fituar aftësi dhe njohuri të reja.
- Sigurimi i mjeteve të nevojshme financiare për kontrollin në vendngjarje të projekteve nga IPA.

Qëllimi direkt 2.2.

Kryerja e zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve të Trupit të Revizionit.

Aktivitete

- Planifikimi i zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve në Trupin e Revizionit nëpërmjet zbatimit të Planit Vjetor të Trajnimit (trajnime për punonjësit e rinj, për përfshirjen e tyre të shpejtë në procesin e punës, trajnime për metodologjinë e revizionit, trajnime për verifikimin në terren, përdorimi i udhëzimeve të KE-së, trajnime për aplikimin e teknologjisë së informacionit në revizion dhe shkëmbimin e përvojave me trupat e revizionit nga vendet e tjera, trajnime për përafrimin e punëve të AA-së, me rregulloren e re IPA III), dhe një mundësi për stazhimin në institucionet kompetente të revizionit në vendet e BE-së dhe Drejtoritë e Përgjithshme në Mbretërinë e Belgjikës, të cilat janë përgjegjëse për punën e Trupit të Revizionit.

QËLLIMI STRATEGJIK 3

Sigurimi i cilësisë së revizioneve të kryera

Zhvillimi dhe përmirësimi i procedurave për kryerjen e revizioneve, në pajtim me rregulloret IPA dhe miratimi i standardeve të pranuara ndërkombëtarisht, për revizionin dhe ndjekjen e efekteve të revizioneve;

Qëllimi direkt 3.1.

Zbatimi i revizioneve në pajtim me standardet e revizionit të pranuara ndërkombëtarisht, manualet e brendshme të punës të Trupit të Revizionit dhe drejtimet dhe udhëzimet e marra nga Drejtoritë e Përgjithshme kompetente të Komisionit Evropian, me qëllim përmirësimin e sistemit të sigurimit të cilësisë së revizionit.

Aktivitete

- Përgatitja e strategjive të revizionit në baza trevjeçare nga programet, dhe përditësimi i tyre në baza vjetore në pajtim me standardet e revizionit, drejtimet dhe udhëzimet e pranuara ndërkombëtarisht nga Komisioni Evropian.
- Harmonizimi i planeve, programeve dhe listave të kontrollit të revizionit me Udhëzimet dhe kërkesat nga drejtoritë kompetente të KE-së.

Qëllimi direkt 3.2.

Sigurimi i cilësisë së rezultateve të revizionit në pajtim me standardet e revizionit të pranuara ndërkombëtarisht.

Aktivitete

- Sigurimi i mbulimit të mjaftueshëm të proceseve, transaksioneve, aktiviteteve në strukturën kompetente lëndë e revizionit të ngarkuar me menaxhimin e fondeve IPA, me qëllim dhënien e mendimit të duhur të revizionit për plotësinë, saktësinë dhe besueshmërinë e raporteve financiare vjetore ose ekstrakteve, dhe llogarive vjetore adekuate, funksionimin efikas dhe efektiv të sistemeve të menaxhimit, kontrollit dhe mbikëqyrjes, si dhe ligjshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve;
- Pajtueshmëria me udhëzimet dhe procedurat për kryerjen e revizioneve dhe nxjerrjen e konkluzioneve të qarta, gjetjeve dhe rekomandimeve cilësore;
- Përmirësimi i kontrollit të cilësisë së punës së revizionit të kryer, në pajti me standardet e revizionit të pranuara ndërkombëtarisht dhe përmeszbatimit të mëvonshëm të manualeve dhe udhëzimeve metodologjike;
- Planifikimi në kohë dhe shprehja e nevojës për përdorimin e punës së një revizori ose eksperti tjetër, me qëllim sigurimin në kohë të mjeteve buxhetore, publikimin e një tenderi dhe lidhjen e një kontrate;

Qëllimi direkt 3.3.

Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve nga subjektet e revizionit dhe ndryshimeve në sistemin e menaxhimit, kontrollit dhe mbikëqyrjes.

Aktivitete

- Planifikimi dhe zbatimi i ndjekjes së rekomandimeve nga revizionet e kryera, dhe masat e marra nga subjekti i revizionit për të kapërcyer dobësitë dhe parregullsitë e identifikuara (brenda revizioneve ose si zbatim i një angazhimi të veçantë të revizionit për ndjekjen e rekomandimeve);
- Ndjekja e ndryshimeve dhe rreziqeve në sistemin e menaxhimit, kontrollit dhe mbikëqyrjes me IPA;
- Dorëzimi i Informacionit në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut, për Raportet dhe Mendimet Vjetore me propozim konkluzione për marrjen e masave dhe aktiviteteve, për tejkalimin e dobësive të identifikuara në sistemin e menaxhimit dhe mbikëqyrjes me IPA.

QËLLIMI STRATEGJIK 4

Zhvillimi i sistemit të informacionit dhe teknologjisë informatike

Zhvillimi dhe mirëmbajtja e mëtejshme e sistemit të informacionit të Trupit të revizionit, zbatimi i teknologjisë informatike dhe përdorimi racional dhe efikas i tij në revizion;

Qëllimi direkt 4.1.

Zbatimi dhe mirëmbajtja e sistemit të informacionit të Trupit të Revizionit, shfrytëzimi racional dhe efikas i pajisjeve informatike.

Aktivitete

- Ndjekja e realizimit të planit të veprimit të strategjisë së TI-së, dhe përditësimi i tij;
- Zbatimi i standardeve të sigurisë për mbrojtjen e të dhënave dhe informacioneve;
- Ndjekja e tendencave në fushën e pajisjeve informatike, dhe prokurimit të harduerëve dhe softuerëve, sipas nevojave të Trupit të Revizionit;
- Mirëmbajtja dhe aplikimi i softuerit të revizionit për përzgjedhjen e mostrave statistikore, dhe softuerit për punën e zyrës dhe e-arkivi;
- Prokurimi i Programeve të Revizionit, përmes një projekti të mbështetur nga Delegacion i Bashkimit Evropian;
- Qasja në Platformën Nacionale për Ndërveprim dhe mundësia e përdorimit të saj;
- Blerja e një serveri back up për vendndodhjen në Prilep të Trupit të Revizionit (Disaster Recovery Center), i cili do të funksionojë në nivel shtetëror.
- Prokurimi i shërbimeve për virtualizimin e mjedisit të serverit dhe për migrimin nga serverat fizikë në atë virtual në Trupin e Revizionit.

QËLLIMI STRATEGJIK 5

Zhvillimi i sistemit të komunikimit

Zhvillimi i mëtejshëm i sistemit të komunikimit dhe shkëmbimit të informacionit me strukturën kompetente për IPA-n, me subjekte juridike vendase dhe ndërkombëtare, dhe informimi i publikut për punën e Trupit të Revizionit.

Qëllimi direkt 5.1.

Zhvillimi i mëtejshëm dhe përmirësimi i vazhdueshëm i mënyrës, metodave dhe përdorimit të praktikave të mira në komunikim, dhe informim të Drejtorive të Përgjithshme përkatëse të Komisionit Evropian dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, si dhe strukturave kompetente në Republikën e Maqedonisë së Veriut, përgjegjëse për menaxhimin e decentralizuar/indirekt, kontrollin dhe mbikëqyrjen e IPA-s në pajtim me kornizën, marrëveshjet sektoriale, financiare dhe rregulloret e Bashkimit Evropian.

Aktivitete

- Miratimi i Strategjisë së Komunikimit të Trupit të Revizionit;
- Përgatitja dhe dorëzimi në kohë i strategjive të revizionit dhe përditësimi i tyre;
- Përgatitja në kohë dhe dorëzimi i raporteve përfundimtare të revizionit të sistemit, sipas IPA III në drejtoritë kompetente në Komisionin Evropian;
- Përgatitja dhe dorëzimi në kohë i Mendimeve vjetore të revizionit, dhe raporteve vjetore të revizionit në drejtoritë kompetente në Komisionin Evropian, dhe në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut (për IPA II dhe IPA III);
- Përgatitja dhe dorëzimi i draft raporteve dhe atyre përfundimtare nga revizionet e kryera të sistemit, revizionet e operacioneve dhe revizionin e llogarive në strukturat kompetente në Republikën e Maqedonisë së Veriut;
- Përgatitjen dhe dorëzimin e rezultateve të revizioneve të kryera nga anëtarët e Grupit të Revizorëve për programet e bashkëpunimit ndërkufitar, që i nënshtrohen revizionit pranë trupave kompetente të revizionit;
- Përgatitja dhe dorëzimi i mendimeve shtesë të revizionit dhe raporteve të revizionit, me kërkesë të Drejtorive të Përgjithshme kompetente;
- Raportimi mbi zbatimin e strategjive të revizionit pranë komisioneve përkatëse të ndjekjes së zbatimit të mjeteve nga IPA,
- Kryerja e revizioneve me kërkesë të drejtpërdrejtë të DG NEAR (revizionet e harmonizimit të sistemit të menaxhimit dhe kontrollit në Republikën e Maqedonisë së Veriut, me mjetet nga periudha e programimit IPA III 2021-2027)

Qëllimi direkt 5.2.

Shkëmbimi i informacioneve, bashkëpunimi ndërkombëtar dhe informimi i publikut për punën e Trupit të Revizionit.

Aktivitete

- Përditësimi i vazhdueshëm i UEB faqes së Trupit të Revizionit;
- Sigurimi i linjës nacionale private nEPL Ethernet, me qëllim të lidhjes së pjesës së back up në vendndodhjen e TR-së në Prilep (Disaster Recovery Center), që do të funksionojë në nivel shtetëror;
- Organizimi i takimeve të punës me përfaqësues të Drejtorive të Përgjithshme kompetente, Shteteve Anëtare dhe vendeve kandidate për anëtarësim në Bashkimin Evropian, me qëllim konsultimin për çështje të hapura, fitimin e përvojës, njohurive dhe praktikave të mira;
- Përfundimi i memorandumeve të bashkëpunimit me institucionet përkatëse në vend, me qëllim nxitjen e efikasitetit dhe efektivitetit në punën e Trupit të Revizionit.

Sipas qëllimeve të përcaktuara, prioritetet e Trupit të Revizionit për Revizionin IPA për periudhën 2025-2029 janë:

- Realizimi i kompetencave të përcaktuara me Ligjin për Revizionin e IPA-s;
- Zbatimi i revizioneve të planifikuara të përcaktuara nga strategjitë trevjeçare të revizionit, si dhe zhvillimi dhe përmirësimi i procedurave për kryerjen e revizioneve në pajtim me rregulloret e IPA-s, dhe standardet e miratuara të pranuara ndërkombëtarisht për revizionin dhe ndjekjen e efekteve të revizioneve të kryera;
- Përmirësimi i procesit të menaxhimit efikas dhe efektiv të fondeve IPA, llogaridhënies dhe transparencës në përdorimin e tyre, duke siguruar vazhdimisht integritetin dhe cilësinë në revizione, me qëllim të ofrimit të mendimeve dhe rekomandimeve të duhura të revizionit, për funksionim më efektiv dhe të qëndrueshëm të sistemeve kompetente për menaxhimin, kontrollin dhe mbikëqyrjen e ndihmës së paranëtarësimit të BE-së në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe
- Sigurimi i vazhdueshëm i cilësisë në punë duke forcuar kapacitetet, duke rritur shkallën e kualifikimit, si dhe duke fituar aftësi dhe njohuri të reja dhe zhvillim profesional.

ZBATIMI I QËLLIMEVE STRATEGJIKE

Gjatë realizimit të këtij plani strategjik, nëse paraqitet nevoja e revizionit të qëllimeve strategjike, ai do të përditësohet në pjesën e aktiviteteve, rezultatet e pritshme dhe afatet e zbatimit, në nivel vjetor.
Për zbatimin e kompetencave ligjore, nëpërmjet realizimit të objektivave strategjikë, Trupi i Revizionit do të vazhdojë të forcojë kapacitetet dhe të sigurojë një nivel të lartë kompetence dhe efektiviteti, në kryerjen e revizioneve në pajtim me rregullat dhe rregulloret e Bashkimit Evropian, dhe standardet përkatëse të revizionit të pranuara ndërkombëtarisht (ISSAI).

NDJEKJA E REALIZIMIT TË QËLLIMEVE STRATEGJIKE

Ndjekja e zbatimit të aktiviteteve të planifikuara, rezultateve të pritshme dhe afateve të përcaktuara në Planin e Veprimit, për arritjen e objektivave strategjikë të Trupit të Revizionit, kryhet në vazhdimësi nga drejtuesit e Trupit të Revizionit.
Realizimi i qëllimeve strategjike monitorohet nëpërmjet treguesve të përcaktuar, nëpërmjet të cilëve matet shkalla e arritjes së qëllimeve të përcaktuara në nivelin afatshkurtër dhe afatmesëm.

FAKTORË RREZIKU PËR ZBATIMIN E SUKSESSHËM TË QËLLIMEVE STRATEGJIKE

Zbatimi i qëllimeve strategjike kushtëzohet nga:

- përforcimi i pavarësisë, rolit dhe vendit të Trupit të Revizionit, për revizionin në sistemin e decentralizuar/indirekt të menaxhimit, kontrollit dhe mbikëqyrjes së mjeteve të alokuara në kuadër të IPA-s;
- sigurimin e burimeve të nevojshme financiare për realizimin dhe zbatimin e qëllimeve strategjike me buxhetet vjetore të Trupit të Revizionit;
- krijimin e kushteve për mbajtjen dhe motivimin e punonjësve në Trupin e Revizionit.

SIGURIMI I MJETEVE FINANCIARE PËR ZBATIMIN E QËLLIMEVE STRATEGJIKE

Tabela: Burimet e nevojshme financiare për zbatimin e qëllimeve strategjikë

Qëllimet direkte	2025	2026	2027	2028	2029
1	2	3	4		
1.1 Mirëmbajtja e vazhdueshme e pavarësisë funksionale dhe operative e Trupit të Revizionit nga sistemet e menaxhimit, kontrollit dhe mbikëqyrjes së fondeve IPA. 1.2 Zhvillimi i mëtejshëm i pavarësisë funksionale dhe organizative të Trupit të Revizionit. 2.1 Sigurimi i burimeve të nevojshme financiare, për ushtrimin e kompetencave të Trupit të Revizionit, dhe forcimin e burimeve njerëzore. 3.2 Sigurimi i cilësisë së rezultateve të revizionit në pajtim me standardet e revizionit të pranuara ndërkombëtarisht. 3.3 Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve nga subjektet e revizionit, dhe ndryshimeve në sistemin e menaxhimit, kontrollit dhe mbikëqyrjes. 4.1 Zbatimi dhe mirëmbajtja e sistemit të informacionit të Trupit të Revizionit, shfrytëzimi racional dhe efikas i pajisjeve informatike. 5.1 Zhvillimi i mëtejshëm dhe përmirësimi i vazhdueshëm i mënyrës, metodave dhe përdorimit të praktikave të mira në komunikim, dhe informim të Drejtorive të Përgjithshme përkatëse të Komisionit Evropian, dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, si dhe strukturave kompetente në Republikën e Maqedonisë së Veriut, përgjegjëse për menaxhimin e decentralizuar/indirekt, kontrollin dhe mbikëqyrjen e IPA-s në pajtim me kornizën, marrëveshjet sektoriale, financiare dhe rregulloret e Bashkimit Evropian. 5.2 Shkëmbimi i informacioneve, bashkëpunimi ndërkombëtar dhe informimi i publikut për punën e Trupit të Revizionit.	40 - Paga dhe kompensime 42.570.000 mkd	40 - Paga dhe kompensime 57.638.000 mkd	40 - Paga dhe kompensime 59.825.000 mkd	40 - Paga dhe kompensime 62.237.000 mkd	40 - Paga dhe kompensime 62.237.000 mkd
2.1 Sigurimi i burimeve të nevojshme financiare, për ushtrimin e kompetencave të Trupit të Revizionit, dhe forcimin e burimeve njerëzore. 2.2 Kryerja e zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve të Trupit të Revizionit. 3.1 Zbatimi i revizioneve në pajtim me standardet e revizionit të pranuara ndërkombëtarisht, dhe drejtimet dhe udhëzimet e marra nga Drejtoritë e Përgjithshme kompetente të Komisionit Evropian, dhe përmirësimi i sistemit të sigurimit të cilësisë së revizionit.	42. Mallra dhe shërbime 8.950.000 mkd	42. Mallra dhe shërbime 23.637.000 mkd	42. Mallra dhe shërbime 23.540.000 mkd	42. Mallra dhe shërbime 23.498.000 mkd	42. Mallra dhe shërbime 23.532.000 mkd

3.2 Sigurimi i cilësisë së rezultateve të revizionit në pajtim me standardet e revizionit të pranuara ndërkombëtarisht. 3.3 Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve nga subjektet e revizionit, dhe ndryshimeve në sistemin e menaxhimit, kontrollit dhe mbikëqyrjes. 4.1 Zbatimi dhe mirëmbajtja e sistemit të informacionit të Trupit të Revizionit, shfrytëzimi racional dhe efikas i pajisjeve informatike. 5.1 Zhvillimi i mëtejshëm dhe përmirësimi i vazhdueshëm i mënyrës, metodave dhe përdorimit të praktikave të mira në komunikim, dhe informim të Drejtorive të Përgjithshme përkatëse të Komisionit Evropian, dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, si dhe strukturave kompetente në Republikën e Maqedonisë së Veriut, përgjegjëse për menaxhimin e decentralizuar/indirekt, kontrollin dhe mbikëqyrjen e IPA-s në pajtim me kornizën, marrëveshjet sektoriale, financiare dhe rregulloret e Bashkimit Evropian. 5.2 Shkëmbimi i informacioneve, bashkëpunimi ndërkombëtar dhe informimi i publikut për punën e Trupit të Revizionit.					
4.1 Zbatimi dhe mirëmbajtja e sistemit të informacionit të Trupit të Revizionit, shfrytëzimi racional dhe efikas i pajisjeve informatike.	48- Shpenzime kapitale 750.000 mkd	48- Shpenzime kapitale 3.905.000 mkd	48- Shpenzime kapitale 879.000 mkd	48- Shpenzime kapitale 863.000 mkd	48- Shpenzime kapitale 819.000 mkd

Numri _____

Shkup, _____

u. d. Revizor Kryesor për IPA

Arben Ramadani, ОДР, ОС

Përpunoi, mr. Sonja Simeonova, ODR
Kontrolloi: Biljana Ivanovska, ODR